REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

# NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 28.12.2022, mori në shqyrtim raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve.

Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 952, datë 28.12.2022 vendosi:

I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

II. Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA të mos përdorë në asnjë rast elementët e mëposhtëm:
   a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
   b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
   c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
   d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

III. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

Për më tepër, ju lutem konsultohuni me faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në http://caa.gov.al.